# Tregu i zi i armëve, "i infiltruari" blen 1 mln lekë kallashnikovin në mes të Durrësit

14 Mars, 2023 21:16

Madhësia e tekstit: ⊖ ⊕

Fiks Fare tregoi me video e audio se sa e lehtë është të blesh të gjitha llojet e armëve pa patur asnjë leje nga policia për përdorimin dhe shitjen e tyre.

Gazetarët e Fiksit kanë mundur të bëjnë pazare për blerje pistoletash dhe automatikësh, madje kanë arritur dhe të blejnë automatik kallashnikov. Pazaret dhe blerjen bëhen në mes të ditës në një nga qytetet më të mëdha të vendit, siç është qyteti i Durrësit.

Arma e zjarrit bashkë me fishekë  iu shit gazetarëve të Fiksit kundrejt 1 milionë lekëve të vjetra. Madje shitësi u premton se mund t'u sgurojë fare lehtë edhe pistoletë, në varësi të kërkesës.

Bisedat e para mes shitësit dhe bashkëpunëtores së Fiksit bëhen në një lokal, ku thuhet se pistoleta kushton 1 milionë e gjysmë lekë.

Dhe vetëm 2 ditë më vonë bashkëpunëtorja e Fiksit bën pazare për të blerë një automatik tek i njëjti person, këtë herë kundrejt 1 milionë lekëve.

Shitësi i prezantuar si Marin Prenga, i siguron bashkëpunëtores se arma është në gjendje shumë të mirë, dhe se më parë ka shitur edhe dinamit, por tani ka frikë.

Shitësi i armës e mori bashkëpunëtoren e Fiksit deri në vendin ku e mbante armën që ishte një hambarë bari. Aty edhe i tregon karikatorin me fishekë dhe e risiguron se arma është e rregullt.

Menjëherë gazetarët e Fiksit e dorëzuan armën në Komisariatin e Policisë Durrës kundrejt të gjitha procedurave ligjore.

Dhe pas këtij momenti forcat operacionale të komisariatit në bashkëpunim me gazetarët e Fiksi lokalizuan dhe kapën shtetasin Maren Presku i prezantuar për bashkëpunëtorët e Fiksit me emër tjetër.

**Takimi i parë me shitësin e armëve**

Fiksi: Ju mirë kaloni?

Shitësi: Mirë kalojmë, shtyjmë.  Muhabetin ta kam thënë unë ty, kjo e don (pistoletën) për një mjek

Fiksi: Infermier jo mjek

Shitësi: Infermier

Shoku i shitësit : Nuk më intereson më gjatë

BW Download on the App Store GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Dosja e Prokurorisë/ "Zbërthehet' masakra e Don Boskos, dyshohet se sulmi në lokal ishte shenjë hakmarrje nga Ervis Martinaj

Klodiana Lala | 14 Mars, 2023

Gjoba 3.6 milionë euro ndaj Birra Tiranës, reagon Gjekmarkaj: "Gjobë edukative" për shkak të qëndrimeve të linjës editorale të mediave, qeveria të tejkalojë gjuhën e forcës

14 Mars, 2023

"Do të ishe më mirë e vdekur apo e gjallë?", prindi tronditet nga pyetësori që i dorëzohet nga edukatorja: Çfarë bëhet, o vëlla?

14 Mars, 2023

INTERVISTA/ "Maniak dhe i dhunshëm", flet Elena Hysa: E dija për borxhin që Dan Hutra i kishte dhënë të dashurës së tij

14 Mars, 2023

Akuzat për Dani Alves, Pique: Nëse vërtetohen dyshimet, do të isha edhe më i ashpër se sa drejtësia

14 Mars, 2023

"Vendimi i KQZ, dëshmi e diktaturës moderne", Aldo Bumçi: Rama ka frikë! Ndëshkimi më i madh nis me votë

14 Mars, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

Fiksi: Ai e do për hall sepse në Kashar ka hapur një blegtori, s'di si ta shpjegoj. Edhe i kanë vjedhur nja dy gjëra me thënë të drejtën.

Shoku i shitësit: Është problem ajo punë nuk është siç ka qenë më përpara,

Fiksi: Unë prandaj i tha Marinit se e njoh,

Shitësi: Kam pas shit shpesh kapsolla dinamiti,

Fiksi: Ku e gjeje dinamitin ti?

Shitësi: Tash nuk ka ma, nuk du me ra në burg, nuk kam më moshë. Pashah kryt e kalamajve me nejt 40 vjet shok edhe gru edhe dashnore me mua, unë me të besu nuk të besoj njëherë, erdhi koha.

Fiksi: Sa ? Më thuaj çmimet dhe të vijë tjetri të bëjë muhabet me ty,

Shitësi: Do bëhet sa më shpejt por edhe ashtu shpejt nuk bëhen gjërat, tani ka probleme për atë sen (pistoletë) ajo.

Fiksi: Tani sa shkon që të përgatitet?

Shitësi: Kanë shku shtrenjtë, janë tu shku shtrenjt, shkon e gjysmë ajo (1 milion e gjysëm lekë)

Fiksi: 1 e gjysmë, po mirë shumë mirë, që t'ja them. Do t'i them unë atij të vijë të bësh muhabet vetë.

Shitësi: Jo, s'dua hiç, s'dua hiç fare që të vijë të bëjë muhabet. Kur të vijë me marrë mallin, vjen shef mallin merr mallin, i pëlqen nuk i pëlqen.

**Takimi ku blihet dhe arma automatik, kallashnikov**

Fiksi: Marin, lekët i kam unë. Ai është rreth 1 km aty te rrethrrotullimi ku është ajo, ai marketi .

Shitësi: Po unë ta fus këtu, në makinë këtu tak

Fiksi: Po mirë, po hajde tani se nuk bëhenj muhabetet në këmbë.

Shitësi: Hajde shkojmë e futna atje

Fiksi: Hajde hip në makinë. Muhabeti është që të mos fëlliqem edhe unë, është e saktë ajo?

Shitësi: Për kryt e kalamajve ee

Fiksi: Se vjen më merr mua…

Shitësi: Jam 55 vjeç burrë unë, për kry të fëmijëve akull e re. Këtu këtu, kësaj rrugice këtu në krahë të majtë. Kaloi këto makina. Ore unë kam një fjalë nuk e lëvizi,

Fiksi: Po ku të vij unë tani? Do vijmë në këmbë ne ?

Shitësi: Ja moj këtu te barakja, këtu brenda te bari.

Fiksi: Do vij unë pas teje, të siguroi makinën 1 minutë.

Shitësi: Me mua je.

Fiksi: O Marin

Shitësi: Hajde këtu.

Fiksi: Hape njëherë ore. Është er pastër?

Shitësi: Oo, oo, po po rri pa fije maraku, tash ti ke me më thënë Marin, shumë faleminderit prej teje.

Fiksi: Tani a ka ndonjë gjë që vihet këtu brenda? Ça është ajo?

Shitësi: Mbaje këtë (karikatoren) . Ja ku është dhe karikatorja

Fiksi: Paska dhe fishekë ë?

Shitësi: Plot me fishekë.

Fiksi: Nuk e provon dot?

Shitësi: Ee ku je në ’97-ën ti? Shko e provoje natën atje.  Ti ke me më marrë prapë në telefon sonte, Marin çdo gjë në rregull

DFiksi: Po se ai do ta provojë atje ku të gjejë hapësirë

Shitësi: Po, po

Fiksi: Atëherë këtu janë 1 milionë

Shitësi: Shumë bukur

Fiksi: Prit ti numëroi  1,2,3,4,5,6,7, 8,9,10 . 1 2 3 4 5 6 7 8 9 20 20 herë 5 bëjnë 1 milionë.

Shitësi: Bukur, po

Fiksi: Hajt ma sill ti deri te makina.  I ka (fishekët), sa kishim këtu brenda?

Shitësi: 30.

Fiksi 30.

/top.channel/

Për t’u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t’ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

**Etiketa:** arme Durres

## TË NGJASHME

**Njëri në pranga për vjedhje, një tjetër për dhunë në familje, 3 të arrestuar në Durrës**
14 Mars, 2023

**Rikualifikimi i akuzës pas gjetjes së armëve, si u hapën dyert e burgut për Fation Muratin, pas masakrës në Don Bosko policia…**
14 Mars, 2023

Taboola Feed



**If you own a mouse, you will never turn off your computer again.**
No Install. Play for free.
Mars Battle | Sponsored
Play Now

**A superyacht is a dream come true for artisans**
Superyacht Life | Sponsored

**U përfshi në sherrin e të shoqit, kjo është bashkëshortja e Robert Aliajt (FOTO)**

U përfshi në sherrin e të shoqit, kjo është bashkëshortja e Robert Aliajt (FOTO)
balkanweb.com

**Here's What Liposuction In Mexico Might Cost You!**
Liposuction Cost | Sponsored

## TË FUNDIT NGA -KRONIKË

**Masakra në "Don Bosko"/Zbardhen detaje të reja, gjithçka ndodhi për 23 sekonda, ja itinerari që kanë ndjekur autorët, 5 persona...**
Igli Çelmeta | 14 Mars, 2023

**Dosja e Prokurorisë/ "Zbërthehet' masakra e Don Boskos, dyshohet se sulmi në lokal ishte shenjë hakmarrje nga Ervis Martinaj**
Klodiana Lala | 14 Mars, 2023

**INTERVISTA/ "Maniak dhe i dhunshëm", flet Elena Hysa: E dija për borxhin që Dan Hutra i kishte dhënë të dashurës së tij**
14 Mars, 2023

**Makina në Kurbin shpërthen në flakë teksa lëvizte, drejtuesi i mjetit përfundon te Trauma, i shpëton vdekjes**
14 Mars, 2023

**Vrasje në tentativë dhe armëmbajtje pa leje, arrestohet 43-vjeçari shqiptar në Itali që plagosi bashkëkombësin**
14 Mars, 2023

**Arrestohet shefi i stërvitjes në RENEA, kapet me 113 mijë euro në "Audi" (EMRI)**
14 Mars, 2023

## KATEGORIA VIDEO

**"Plani për të dëmtuar opozitën, i paracaktuar nga mazhoranca"/ Silva Caka: Një parti politike s'mund të formohet nga vendimet e gjykatës**
14 Mars, 2023

**Zgjedhjet e 14 Majit/ "Vendimi për mos regjistrimin e PD i shërbeu vetëm Ramës", Baçi: KQZ po vijon lojën politike**
14 Mars, 2023

**Dosja e Prokurorisë/ "Zbërthehet' masakra e Don Boskos, dyshohet se sulmi në lokal ishte shenjë hakmarrje nga Ervis Martinaj**
Klodiana Lala | 14 Mars, 2023

**INTERVISTA/ "Maniak dhe i dhunshëm", flet Elena Hysa: E dija për borxhin që Dan Hutra i kishte dhënë të dashurës së tij**
14 Mars, 2023

**"Vendimi i KQZ, dëshmi e diktaturës moderne", Aldo Bumçi: Rama ka frikë! Ndëshkimi më i madh nis me votë**
14 Mars, 2023

**"Valët" e Virxhinia Ulf në skenën e Teatrit të Metropolit, aktori Jozef Shiroka: Pjesë komplekse! Ndjehet gëzimi i autores për të jetuar**
Fatmira Nikolli | 14 Mars, 2023

BalkanWeb

**FAQET ZYRTARE**
TV News24 Live
News24.al
Radio RASH

**PRIVATËSIA**
POLITIKA E PRIVATËSISË

**KONTAKT**
redaksia@balkanweb.com

**EMISIONE NEWS24**
Alert
Autoktonët
Dola te Ola
Emisioni Vila 24
Fit Station
Frontline
Jeta_pa_filtër
Kjo Javë
Klinika 24
Koha për t'u zgjuar
Me zemër të hapur
Në mëngjes me Klarkun
Në shënjester
Open
Pikat mbi i
Sport News
Sport News Plus

**KATEGORI**
Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

**MEDIAT E HUAJA**
New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.